



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 585 Akti

nr. 480 Vendimi
Tiranë, më 6.12.2021

V E N D I M

Trupi gjyqësor i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Genta Tafa Bugo	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datën 6.12.2021, në mjediset e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Armanda Xhaferri**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

BAZA LIGJORE : **Nenet 179/b dhe “G”, të Kushtetutës; neni 56 i ligjit nr.84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; **Vendimi nr.78**, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Armanda Xhaferri ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Referuar përcaktimeve të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* dhe është shortuar nga Komisioni në shortin e datës 15.6.2020.
2. Znj. Armanda Xhaferri ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë një kërkesë, bazuar në pikat 1 dhe 2, të nenit 65, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në pikën 8, të nenit 164, në pikën 2 të nenit 166, si dhe në germën “a”, të pikës 1, të nenit 189, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, për dorëheqjen e saj nga detyra e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Kjo kërkesë është paraqitur me e-mail edhe në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për informacion në datën 28.10.2021.
3. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me shkresën nr. *** prot., datë 18.11.2021, ka informuar Komisionin e Pavarur të Kualifikimit mbi vendimin nr. ***, datë 16.11.2021, të Këshillit të

Lartë të Prokurorisë, “Për mbarimin e statusit të magjistratit” të znj. Armanda Xhaferri për shkak të dorëheqjes. Ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim.

II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

4. Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen:

“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.

2. Subjekti i rivlerësimit, që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare”.

5. Neni 56 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar të drejtën e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, si vijon:

“1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.

2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas pikës 1, të nenit 7, të ligjit ‘Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit’” .

6. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon:

“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se për sa kohë subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe, në këtë rast, procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës”.

7. Në vijim të procesit të rivlerësimit, Komisioni është vënë në dijeni të kërkesës për dorëheqje nga ushtrimi i funksionit të prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nga subjekti Armanda Xhaferri. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka njohur Komisionin me vendimin nr. ***, datë 16.11.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të dorëheqjes së paraqitur nga znj. Armanda Xhaferri.

8. Komisioni e ka pyetur znj. Armanda Xhaferri, nëpërmjet komunikimit elektronik, nëse dëshiron të dëgjohet në një seancë dëgjimore publike, e cila është përgjigjur, nëpërmjet e-mail-it në datën 23.11.2021, se nuk dëshiron të dëgjohet apo të marrë pjesë në një seancë dëgjimore publike, as vetë dhe as nëpërmjet ndonjë përfaqësuesi.

9. Komisioni ka konstatuar se vendimi nr. ***, datë 16.11.2021, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë ka marr formë të prerë, pasi ai nuk është ankimuar.

10. Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njej Kushtetuta për dorëheqje. Kjo sjell si pasojë ndërprerjen e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i

Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Armanda Xhaferri, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (përfunduar në datën 30.11.2021).
2. Ndalimin e emërimit të znj. Armanda Xhaferri, si gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në datën 6.12.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Valbona SANXHAKTARI
Relatore

Genta TAFA (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku